

15 Janar 2024

Pyetjet më të shpeshta të përcjella në kuadër të Thirrjes për Projekt-Propozime

Frequently Asked Questions

1. Ju përmendët që do ketë një auditim për organizatat fituese, duhet ta kostojmë në buxhet në buxhet?

Të gjitha projektet e nëngrantuara do t'i nënshtrohen auditimit të posaçëm sipas kërkesave të projektit. Audituesi i përzgjedhur për të mbuluar procedurat në kuadër të projektit rajonal do të realizojë auditimin e projekteve të nëngrantuara gjithashtu, kështu që nuk lind nevoja për të buxhetuar shërbimin në këto projekte.

2. Cili ishte subjekti i *email*-it për dërgimin e aplikimit, pasi nuk ishte specifikuar te thirrja?

Partnerët nuk kanë specifikuar një *subject line* të caktuar për përcjelljen e projekt-propozimeve. Specifikojmë që për të siguruar marrjen e dokumentacionit prej nesh, lutemi mbetuni në pritje të një *email*-i konfirmues zyrtar nga adresa office@ahc.org.al, në përgjigje të email-it tuaj përcjellës. Në rast se nuk merrni një *email* konfirmues brenda 12 orëve nga përcjellja e dokumentave në ditët zyrtare të punës, lutem kontaktoni sërish office@ahc.org.al.

3. Në cilin muaj pritet të fillojë zbatimi i projekteve?

Procesi i plotë pritet të mbarojë brenda 60 ditëve nga publikimi i thirrjes. Kështu, në zbatim të një procesi të rregullt, projektet priten të fillojnë në mesin e muajit mars.

4. Nëse nuk ka mjaftueshëm fitues, a është e mundur që buxheti të rialokohet për organizatën fituese?

Maksimumi i buxhetit të akorduar reflektohet në dokumentat shoqërues të thirrjes për projekt propozime dhe është 5,500 Euro. Gjithashtu, implikimet rritëse të buxhetit pas kryerjes së procesit të aplikimit janë të palejueshme, kështu që shuma maksimale e cila i akordohet çdo aplikanti do të mbetet 5,500 Euro.

5. Tek buxheti, a ka një proporcion të caktuar midis shpenzimeve administrative dhe atyre për aktivitete?

Jo, nuk ka një proporcion të caktuar që duhet ruajtur midis kostove administrative dhe atyre të aktiviteteve, mjafton që kostot e propozuara të jenë objektive dhe të planifikuara racionalisht. Buxheti dhe objektiviteti i kostove të përfaqësuara në të janë objekt vlerësimi, kështu që një buxhet i pandërtuar racionalisht, mund të marrë më pak pikë përgjatë këtij procesi.

6. A mund të dërgohet aplikimi me postë, apo vetëm me email?

Siç parashikohet në dokumentat e thirrjes, aplikimet mund të dërgohen vetëm elektronikisht.

7. Cfarë ndodh nëse mungon një nga dokumentat në aplikim?

Aplikimi përfshin vetëm dy dokumenta, konkretisht *Annex*-in (Shtojcën) A dhe B, të dy tërësisht thelbësorë për projektin duke qënë se përfaqësojnë projekt-propozimin narrativ dhe buxhetin shoqëruar. Kështu, mungesa e secilit prej këtyre dokumentave do të drejtonte në penalizimin automatik të aplikimit dhe moskalimin e tij në fazat e mëtejshme të vlerësimit.

8. Sa kohë merr shqyrtimi i aplikimeve?

Procesi pritet të përfundojë 60 ditë pas publikimit të thirrjes për projekt-propozime. Sipas kalendarit indikativ, i cili gjendet në Udhëzimet për Aplikantët, rezultati i vlerësimit njoftohet fillimisht më 10 shkurt. Më tej, organizatat e shpallura fituese provizorisht do t'i nënshtrohen procesit të kontrollit të vlefshmërisë.

9. Te pjesa e buxhetimit, regjistrat duhet të ishin të mbajtur nga nje sistem financiar i licensuar që ka organizata, apo jo? Sepse përgjithësisht, për një organizatë jofitimprurëse mbajtja e një sistemi financiar është e kushtueshme, kur kostot e këtij të fundit nuk mbulojnë nga projektet.

Sipas dokumentave të projektit, kostot e pranueshme duhet të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme në regjistrat e kontabilitetit të përfituesit. Kështu, mbajtja e regjistrimit i kostove në këtë formë është element i detyrueshëm për zbatimin e projekteve, të cilët i nënshtrohen dhe kontroleve përkatëse të auditit për të siguruar pranueshmërinë e kostove në tërësi dhe veçanti.

10. A është penalizuese për organizatën fakti që kanë fituar vetëm një projekt që prej 2020?

Mosangazhimet e mëparshme në zbatimin e projekteve nuk janë një kusht taksativ dhe përjashtues për organizatat. Pra, nëse projekt-propozimi plotëson kushtet e pranueshmërisë, ai do të kalojë në fazën e dytë të vlerësimit.